



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2024:297136
Datë: 16.12.2024
Numri i dokumentit: 06600685

C-I-24-0048

Propozuesi/paditësi; I B nga fshati S Komuna e Gjakovës,përfaqësuar nga avokati B M nga Gjakova.

Kundërshtari i sigurimit/e paditura;Agjencia Kosovare e Privatizimit,rruga Dritan Hoxha, nr.55 Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,Kolegji në përbërje nga gjyqtari kryesues Asllan Krasniqi dhe gjyqtarët anëtar;Hajrije Shala dhe Hasim Sogojeva,pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me datën;16.12.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- REFUZOHET në tërësi si i pabazuar propozimi i paditësit/propozuesit për caktimin e masës së sigurimit.
- Secila palë bartë veç e veç shpenzimet e procedurës.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me datën;13.11.2024, paditësi/propozuesi përmes parashtresës së hartuar me shkrim ka bërë propozimin e tij për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit ndaj palës së paditur/kundërshtarit të sigurimit;Agjencia Kosovare e Privatizimit në Prishtinë,lidhur me pretendimet e tija që konsistojnë në ndalimin e shitjes së njësisë me numër 12-KB Bec,për ngastrën kadastrale që evidentohet me numër .në sipërfaqe prej;285 m2 dhe për ngastrën kadastrale me numër .. në sipërfaqe prej 65 m2 të dyja këto ngastra në sipërfaqe prej;350 m2 të cilat shtrihen në zonën kadastrale S,Komuna e Gjakovës,si dhe të mos ndërmerr kurrëfarë veprimi për transferimin e të drejtave pronësore apo ngarkimin me ndonjë barrë-ngarkesë të paluajtshmërive të lartëcekura.

Lidhur me afatin e kohëzgjatjes së masës së sigurimit i ka propozuar gjykatës që ajo të vazhdon deri në zgjidhjen e kontestit me aktgjykim të plotëfuqishëm, si dhe aktvendimi të regjistrohët në regjistrin publik të Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastrë të Komunës së Gjakovës.

Në mbështetje të padisë, paditësi/propozuesi si provë ka bashkangjitur kopjet e dokumenteve si në vijim:

- Njohtimin e lëshuar nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së të datës;02.10.2024
- Njohtimin e lëshuar nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së të datës;06.09.2024
- Të dhënat lidhur me asetën – shitja e aseteve përmes likuidimit nr.68, njësia e vendosur në tender nr.12 për ngastrat kadastrale me nr.. dhe .. zona kadastrale S, fletën poseduese të datës;. si dhe historiatin e datës;11.07.2005

Kundërshtari i sigurimit në parashtrësën e tij të hartuar me shkrim të datës;26.11.2024 ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e propozuesit I B nga fshati S lidhur me caktimin e masës së sigurimit duke iu referuar dispozitave të nenit 61 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës që konsistojnë në dëmin gjithëpërfshirës dhe të pariparueshëm si dhe dëmin e menjëhershëm duke mos patur mundësinë e një kompensimi financiar, pasi që nuk janë plotësuar kriteret e përcaktuara me ligj të cekura si më lartë i ka propozuar gjykatës që propozimin e propozuesit ta refuzoj në tërësi si pabazuar.

Arsyetimi Ligjor

Propozimi për caktimin e masës së sigurimit është në tërësi si i pabazuar.

Paditësi/propozuesi propozimin e tij për caktimin e masës së sigurimit e ka parashtruar duke iu referuar dispozitave të nenit 61 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit nr.06/L-086.

Pretendimet e palës paditëse/propozuesit lidhur me caktimin e masës së sigurimit për ngastrën kadastrale që evidentohen në ngastrat kadastrale me nr.. dhe . zona kadastrale S Komuna e Gjakovës, të evidentuara në emër të Kooperativës Bujqësore Bec, nuk janë argumentuar me asnjë provë të vetme të besueshme për aprovimin e kësaj mase të sigurimit ashtu si përcaktohet me dispozitën e lartëcekur.

Sipas dispozitës së nenit 61 të këtij ligji, mund të nxjerr një masë të sigurimit me kusht që parashtruesi të ofrojë prova të besueshme se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të pariparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Dëmi konsiderohet si i pariparueshëm vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar.

Barra e provës është tek paditësi/propozuesi, kështu që paditësi përveç që duhet të ofroj dëshmi të besueshme se e drejta e rrezikuar ekziston, duhet të ofrojë dëshmi dhe ta bëjë të besueshme faktin se do të shkaktohet dëm i menjëhershëm dhe i pariparueshëm, nëse nuk aprovohet propozimi për caktimin e masës së sigurimit.

Dëmi i menjëhershëm:

Gjykata vlerëson se edhe kushti për dëm të menjëhershëm nuk është plotësuar, pasi që pronat të cilat janë objekt i këtij kontesti evidentohet në emër të Kooperativës Bujqësore Bec e cila menaxhohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit sipas fletave poseduese të datës;. Në rrethanat e tilla faktike, pa caktimin e masës së sigurimit, nuk ka rrezik që i padituri/kundërshtari i sigurimit do të pamundësonin apo do ta vështirësonin dukshëm realizimin e kërkesës sidomos me tjetërsimin e pasurisë kontestuese, ngarkimin apo në ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do të ndryshonte gjendjen ekzistuese e ngastrave kontestuese dhe kësaj do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të kësaj mase.

Dëmi i pariparueshëm:

Sipas dispozitave ligjore të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit nr.06/L-086, dëmi konsiderohet si i “pariparueshëm” vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar. Në rastin konkret, dëmi nuk mund të jetë i pariparueshëm për paditësin/propozuesin, pasi që në rast të fitim eventual të së drejtës së paditësit në ngastrat kadastrale me nr.. dhe .. zona kadastrale S Komuna e Gjakovës, në fund të kontestit, nuk do të ishte e vështirë caktimi real i dëmit eventual që mund të pësonte paditësi dhe kësaj nuk do të vështirësohet apo nuk do të jetë e pamundur të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar.

Në rastin konkret gjykata ka gjetur se propozimi i paditësit/propozuesit për caktimin e masës së sigurimit nuk ka mbështetje në dispozitën e nenit 61 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, nr.06/L-086, pasi që pretendimi i palës paditëse/propozuesit nuk thirret në asnjë provë relevante në propozimin e tij të hartuar me shkrim që ka të bëjë me propozimin për caktimin e masës së sigurimit, prandaj edhe propozimi i tij si e tillë është refuzuar ashtu si përcaktuar në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Shpenzimet Gjyqësore:

Paditësi/propozuesi lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore, pasi që të njëjtën e ka paguar me datën; 20.11.2024.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktvendimi palët ndërgjyqëse mund të ushtrojnë ankesë me shkrim duke iu drejtuar Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, brenda afatit kohor prej; 15 ditëve duke llogaritur nga data e pranimit të këtij aktvendimi.

Asllan Krasniqi, Gjyqtar kryesues

Hajrije Shala, Gjyqtare anëtare

Hasim Sogojeva, Gjyqtar anëtar